



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.37/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha kryetar, Rustem Thaqi dhe Nenad Laziq, anëtarë, në çështjen juridike të parashtruesve të ankesave të përfaqësuesit të Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në P., të parashtruar nga A. R., Q.K., Q. në Britani të Madhe, F. B., Q. në Gjermani, Z. Z., Q. në Suedi, Q. S., Q. në Zvicër, K. Gj., Q. në Francë, E. P., Qendra në SHBA, K. L., Q. në Norvegji dhe B. R., Q. në Danimarkë, për shkak të miratimit të listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës, numrit të vendotimeve dhe numrit maksimal të votuesve, duke vendosur sipas ankesës së Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.1/2024 dt.3.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 9.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa themeltë ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, në P., paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.1/2024 dt. 3.09.2024.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.1/2024 të dt.3.09.2024, janë hedhur poshtë të palejuara ankesat e përfaqësuesve të Subjektit Politik, Lëvizja

Vetëvendosje, në Prishtinë, A.nr.1/2024 dt.31.08.2024, e parashtruar nga A. R., A.nr.2/2024 dt.31.08.2024, e parashtruar nga Q. K., Q. në Britani të Madhe, A.nr.3/2024 dt.31.08.2024 e parashtruar nga F. B., Q. në Gjermani, A.nr.4/2024 dt.31.08.2024, e parashtruar nga Z. Z., Q. në Suedi, A.nr.5/2024 dt.31.08.2024, e parashtruar nga Q. S., Q. në Zvicër, A.nr.6/2024 dt.1.09.2024, e parashtruar nga K. Gj., Q., në Francë, A.nr.7/2024 dt.31.08.2024, e parashtruar nga E. P., Q. në SHBA, A.nr.8/2024 dt.31.08.2024, e parashtruar nga K. L., Qendra në N., A.nr.9/2024 dt.1.09.2024, e parashtruar nga B. R., Qendra në D., me të cilën kanë kërkuar që vendimi i KQZ-së Nr.1/1305-2024 i datës 29.08.2024, lidhur me vendimin për miratimin e listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës, numrin e vendvotimeve dhe numrin maksimal të votuesve, të shpallet i pavlefshëm dhe të urdhërohet KQZ që të veprojë sipas nenit 96 par.8 i LZP-së, duke hequr kufizimin e tillë të numrit maksimal të votuesve në qendrat e votimit jashtë Kosovës, si dhe të nxjerrë vendim meritator, të arsyetuar në lidhje me këtë çështje në bashkëpunim me MPJD.

Kundër vendimit të sipërpërmendur të PZAP, Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, nëpërmjet përfaqësuesit të sajë, A. R., ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën konteston ligjshmërinë e vendimit të PZAP-it, me propozim që të anulohet vendimi A.nr.1/2024 dt.3.09.2024 i PZAP dhe të urdhërohet KQZ që të heq kufizimin e hapësirave dhe rrjedhimisht të numrit të votuesve që duan të votojnë fizikisht jashtë Kosovës për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe në bashkëpunim me MPJD, sipas obligimit ligjor, të rivlerësojë hapësirat për caktimin e qendrave të votimit jashtë Kosovës dhe numrit të votuesve që mund të votojnë aty.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur PZAP-i, përmes të cilës kundërshton pretendimet ankimore dhe propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes në ankesë si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i, më datën 31.08.2024 dhe datën 1.09.2024, ka pranuar ankesat e paraqitura nga përfaqësuesit e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje, të sipër përmendur, (si në dispozitivin dhe arsyetimin e vendimit), të parashtruara kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.01/1305-2024 dt.29.08.2024, me të cilën

pretendojnë se KQZ, më datën 29.08.2024, në mbledhjen e 46 për vitin 2024, ka marrë vendim për Miratimin e Listës së Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maksimal të Votuesve, ku në pikën I të vendimit thuhet : “ Miratohet lista e qendrave të votimit jashtë Kosovës, numri i vendvotimeve dhe numri maksimal i votuesve, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025 ”. Ndërsa, më tej, PZAP, ka konstatuar se paraqitësit e ankesës, kanë theksuar se bazuar në nenin 119 par.5 të LZP-së, duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes së ngritur, për të “ parandaluar një padrejtësi serioze”, duke e konsideruar si çështje “rreptësishtë e domosdoshme”, e cila bie “nën juridiksionin e tij”, palët ankuese kërkojnë nga PZAP që të shqyrtojë këtë çështje, pasi që bazuar në nenin 96 par.8 i LZP, i cili citon “ KQZ-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, vlerëson hapësirat fizike për secilën përfaqësi diplomatike dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara, merr vendim për numrin e vendvotimeve dhe për numrin e votuesve për secilën përfaqësi diplomatik, jo më vonë se 5 ditë nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve, ku KQZ kërkon nga MPJ, listën e të gjitha përfaqësive diplomatike, bashkë me detajet e nevojshme mbi hapësirën e objekteve, e ku Ministria e Punëve të Jashtme obligohet që t’i ofrojë KQZ-së të gjitha informacionet e kërkuara brenda tre (3) ditë, nga dita e pranimit të kërkesës. MPJ përshtatë hapësirat e objekteve të përfaqësive diplomatike në vendvotime sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ”. Rrjedhimisht, në hapin e parë, vlerësimin e hapësirave fizike për secilën përfaqësi diplomatik, KQZ e bën në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) dhe vetë në hapin e dytë, KQZ, po ashtu në bashkëpunim me MPJ, merr vendim për numrin e vendvotimeve dhe të votuesve. Parashtruesit e ankesave, kanë shtuar më tutje, se me këtë vendim KQZ ka bërë gabim në hapa pasi që nuk ka marrë parasysh veprimet dhe zotimet ligjore të MPJ në këtë drejtim dhe rrjedhimisht ka marrë vendim në mënyrë të njëanshëm dhe arbitrare. Sipas parashtruesve të ankesës, sipas kërkesës ligjore të nenit 96 par.8 të LZP, MPJ brenda afateve ligjore i ka dërguar KQZ përmes emailit, por edhe në takimet fizike, listën e qendrave të votimit me numrin e votuesve që mund të votojnë në ato qendra të votimit jashtë Kosovës ku MPJ, brenda afatit të paraparë ligjor sipas par.8 të nenit 96 të LZP, MPJ është përgjigjur në kërkesën e KQZ. Krahas kësaj, MPJ përmes emailit, më 26 gusht 2024 ka përcjellë në KQZ edhe listën e të gjitha përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës dhe numrin e mundshëm të votuesve që mund të votojnë në hapësirat e këtyre përfaqësive diplomatike të cilat, bazuar në kompetencat dhe të drejtat që rrjedhin sipas të Drejtës Ndërkombëtare (Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike e vitit 1961) garanton se mund të sigurohen nga MPJ brenda afateve të përshtatshme ligjore, si dhe një pasqyrë të të gjitha përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës.

Parashtruesit e ankesave kanë theksuar se nisur nga këto fakte konkrete, shihet qartë se nxjerrja e vendimit nga KQZ nuk është bërë në bashkëpunim me MPJ ashtu siç kërkon neni 96 par.8 i LZP-së, andaj, vendimi i KQZ është arbitrare, i kundërligjshëm, i pa arsyetuar dhe diskriminues në raport me votuesit jashtë Kosovës, pasi që e drejta e votës është e drejtë e garantuar me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe se askush nuk ka të drejtë të kufizojë këtë të drejtë, përveç kur kjo kufizohet me vendim gjyqësor. Prandaj, parashtruesit e ankesave, siç u theksua më lartë, kanë kërkuar që PZAP ta shpallë të pa vlefshëm vendimin Nr.01/1305-2024 dt.29.08.2024, dhe të urdhërojë KQZ që të heq kufizimin e sipër përmendur, për numrin maksimal të votuesve në qendrat e votimit jashtë Kosovës dhe të merr vendim meritore.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka sqaruar ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana e saj duke theksuar në mbledhjen e saj ka caktuar numrin maksimal të votuesve në çdo përfaqësi diplomatike duke u mbështetur në kapacitetin e secilës përfaqësi diplomatike, ku sipas KQZ-së, numri maksimal i bashkë atdhetarëve që mund të regjistrohen për të votuar në një vendvotim është 1000, dhe sipas vlerësimeve të kapaciteteve fizike të përfaqësive diplomatike, votimi do të organizohet në 35 përfaqësi diplomatike, në 22 shtete. Në përgjigjen e saj KQZ thekson se me qëllim të pjesëmarrjes të sa më shumë votuesve në procesin zgjedhor të votuesve që jetojnë jashtë vendit ka paraparë ofrimin e tri mundësive, votimi me postë në kutitë postare të hapura nga KQZ-ja jashtë vendit (në misione diplomatike); dhe votimi me postë në kutinë postare të KQZ-së. Në përgjigjen e saj sqaron se votimi fizik në përfaqësi diplomatike, në bazë të ligjit, është përcaktuar të bëhet pas shëndrrimit të misioneve diplomatike apo hapësirave të tyre si qendra të votimit, por në bazë të kriterëve që përcaktohen nga KQZ-ja, duke u bazuar në dispozitat ligjore që mundësojnë një proces zgjedhor të drejtë dhe efikas, pa u cenuar qytetarëve e drejta e votimit të lirë. Më tutje, ka shtuar se sipas KQZ-së me nenin 96 par.8 të LZP vendimi për numrin e vendvotimeve dhe për numrin e votuesve për secilën përfaqësi diplomatike e merr KQZ-ja, deri sa me MPJD-ën bën vetëm vlerësimin e përbashkët të hapësirave fizike. Rregullorja për Votimin Jashtë Kosovës, në nenin 3, par.7, ka paraparë që në bazë të vlerësimit të kapaciteteve për votim në përfaqësi diplomatike, KQZ përcakton numrin maksimal të votuesve për secilën përfaqësi diplomatike, të caktuar si qendër votimi, kurse, par.8 i Rregullores, e ka paraparë mundësinë e plotësimit të numrit të caktuar dhe si duhet të veprohet pasi të arrihet numri maksimal i votuesve në përfaqësi diplomatike. Në këtë rast, aplikuesi do të udhëzohet për mënyrat tjera të votimit. Prandaj, KQZ në bazë të këtyre dispozitave dhe rrethanave të sipër cekura, në mbledhjen nr.46/2024 dt.29.08.2024, ka miratuar listën e Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës në atë mënyrë

që respektohet kriteri sipas kapaciteteve fizike të përfaqësive diplomatike dhe që garantohet që publikimi i listave do të bëhet në atë mënyrë që u mundëson qytetarëve sa më parë ushtrimin e të drejtës ligjore për aplikim për regjistrim si votues jashtë vendit.

Në këtë gjendje të çështjes dhe për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesave të parashtruesve të sipër cekur, PZAP është mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, veç tjerash, nenit 119 par.3, me të cilin është përcaktuar se “ PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj”. Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesë është specifikuar me nenet 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1, të këtij ligji, si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ndaj, ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të tij. Sipas vlerësimit të PZAP – së, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk përcaktohet me asnjë dispozitë ligjore se mund të ankimohen vendimet e kësaj natyre të KQZ-së, përkatësisht, vendimi i KQZ-së për Miratimin e Listës së Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maksimal të Votuesve, në këtë kuptim, Paneli vlerëson se rasti lëndor nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP, e rrjedhimisht nga kjo edhe ankesat janë të palejueshme. Pretendimet ankimore kur kërkohet që të shqyrtohen këto ankesa duke u bazuar në nenin 119 par.5, të këtij ligji, Paneli vlerëson se kjo dispozitë ligjore nuk krijon juridiksion për shqyrtimin e ankesave nga Paneli për sa i përket vendimit të kësaj natyre, kur nuk është paraparë shprehimisht ankesa ndaj vendimit të KQZ-së, por sqaron qartë se duhet të shqyrtohen vetëm çështjet të cilat janë në juridiksionin e PZAP-it.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, i pranon si të themelta konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të PZAP-it, që ka marrë sipas vendimit të ankimuar lidhur me hedhjen si të palejuara të ankesave të paraqitura nga parashtruesit e sipër përmendur, me që vlerëson se vendimi i këtij organi nuk është i kundërligjshëm dhe nuk është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe as me Rregulloret a legjislacionin sekondar të KQZ dhe PZAP-it.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin thëniet e parashtruesit të ankesës përkitazi me shkeljet e pretenduara, përkatësisht, shkeljet e dispozitave përkatëse të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, mirëpo, në rastin

konkret, këto pretendime u refuzuan si të pabazuara edhe nga kjo Gjykatë, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, ndaj, si të tilla juridikisht, janë të paqëndrueshme. Kështu, për faktin sepse, sikundër u theksua edhe më lartë, veç tjerash, me dispozitën e nenit 119 par.3 parashihet se “ PZAP-ja vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj”. Ndërsa, përkitazi me këtë çështje, se në cilat raste, respektivisht, kundër të cilave vendime të KQZ-së, lejohet ankesa në PZAP, në mënyrë të specifikuar dhe shprehimisht, është paraparë me dispozitat përkatëse të lartë cituara të LZP-së. Po ashtu, në kontekstin e mësipërm, duhet pasur parasysh, veç tjerash, edhe dispozitën e nenit 96 par.6 të këtij ligji, në të cilën është paraparë se “ KQZ, përmes akteve nënligjore, përcakton kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin objektet e përfaqësive diplomatike të shndërruara në hapësira votimi, si dhe përcakton numrin maksimal të votuesve që mund të votojnë, për secilën përfaqësi diplomatike “. Ndaj, kur jemi këtu, duhet theksuar se KQZ, në zbatim të kësaj norme ligjore, dhe jo vetëm, (edhe të dispozitës së nenit 96 par.8) kështu edhe ka vepruar duke miratuar aktet nënligjore, (legjislacionin e vet sekondar) si dhe duke caktuar në pajtim me të, edhe numrin maksimal të votuesve që mund të votojnë në secilën përfaqësi diplomatike. Në anën tjetër, gjithnjë, në kontekstin e mësipërm, dhe në llogari të këtij përfundimi, flet edhe fakti se me LZP, përkatësisht, me dispozitat e nenit 96 par 3, nënp.3.1, 3.2 dhe 3.3 të tij, përveç votimit fizikisht në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës..., (3.1), parashihen edhe dy mundësi tjera të votimit të qytetarëve jashtë vendit, përmes postës..., si në nënp.3.2 dhe 3.3 të këtij ligji. Nga sa u theksua, rezulton se në këtë rast, bëhet fjalë për një tagër (autorizim ligjor – ingerencë – kompetencë) të KQZ, që ka të bëjë me miratimin e listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës, përcaktimin e numrit të vendvotimeve dhe të numrit maksimal të votuesve, gjë që, KQZ edhe e ka bërë në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren përkatëse të sipër përmendur.

Prandaj, nga këtu, kjo Gjykatë, konsideron se në rastin konkret juridik, është marrë vendim i drejtë, me të cilin nuk është bërë diskriminim dhe nuk është cenuar e drejta e votimit si e drejtë themelore e paraparë me Ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nuk janë shkelur parimet themelore të procesit zgjedhor të parapara shprehimisht me dispozitat e nenit 4 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe me Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut, që kanë të bëjnë me garantimin e të drejtës së votës, garantimin e së drejtës së votimit të fshehtë, garantimin e të drejtës të votës së barabartë etj.

Nga këtu, ankuesi, me pretendimet ankimore, nuk ka arritur që të vë në dyshim vendimin e ankimuar të PZAP-it, i cili, për arsyet e sipër cekura, është i drejtë dhe i ligjshëm, andaj, kjo

Gjykatë, ankesën e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, kundër vendimit të kontestuar e refuzoi si të pa themeltë.

Nga arsyet e sipër përmendura , e në pajtim me dispozitën e nenit 118 pika 4 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

AA.nr.37/2024 dt. 9.09.2024

Kryetar i kolegjit,

Mr.Sc.Muhamet Rexha